

METODOLOGJIA PËR PROMOVIMIN E VETËRREGULLIMIT NË MEDIAT LOKALE

Zonat pilot: Shkodër dhe Vlorë



Dorian Matlija, Res Publica
Koloreto Cukali, Këshilli Shqiptar i Medias

Tiranë, 2025

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| 1. Hyrje dhe qëllimi i ndërhyrjes | 3 |
| 2. Justifikimi i ndërhyrjes | 4 |
| 3. Qasja metodologjike..... | 4 |
| 4. Strukturimi i fokus grupeve dhe tryezave të rrumbullakëta | 6 |
| 4.1. Përzgjedhja e pjesëmarrësve | 6 |
| 4.2. Strukturimi i seancave | 7 |
| 5. Ndërthurja me çështje ndërsektoriale | 8 |
| 6. Roli i ekspertëve në këtë metodologji | 9 |
| 7. Rezultatet e pritshme nga kjo metodologji | 10 |
| 8. Përfundime | 12 |

Metodologjia për promovimin e vetërregullimit në mediat lokale

Zonat pilot Shkodër dhe Vlorë

Autorë: Dorian Matlija, Res Publica
Koloreto Cukali, Këshilli Shqiptar i Medias

1. Hyrje dhe qëllimi i ndërhyrjes

Ky raport është hartuar në kuadër të një ndërhyrjeje strategjike që synon të promovojë dhe fuqizojë vetërregullimin në mediat lokale në Shqipëri, përmes një procesi të mirëmbënduar metodologjik dhe pjesëmarrës. Ndërhyrja zhvillohet në kuadër të projektit: “Promovimi i etikës dhe vetërregullimit në mediat lokale. Sfidimi i dezinformimit.”, mbështetur nga Instituti i Medias, në kuadër të projektit “Media Jonë”.

Ky raport përfaqëson rezultatet dhe reflektimet e punës përgatitore të kryer nga ekspertë të fushës së etikës mediatike dhe vetërregullimit, të angazhuar në kuadër të një projektit sipërpërmendur, që zhvillohet në qytetet Shkodër dhe Vlorë si zona pilote. Këto dy qytete janë përzgjedhur për shkak të karakteristikave të tyre unike: ato përfaqësojnë mjedise mediatike me dinamikë aktive, por me burime të kufizuara profesionale dhe institucionale për zbatimin e standardeve të vetërregullimit. Gjithashtu, këto dy qytete janë zgjedhur edhe për të siguruar një përfaqësim më të gjerë gjeografik dhe kulturor.

Në thelb të kësaj ndërhyrjeje qëndron nevoja për të kuptuar dhe adresuar boshllëqet ekzistuese në mënyrën se si mediat lokale i qasen etikës profesionale dhe mekanizmave të vetërregullimit. Ndërsa në nivel kombëtar ekzistojnë struktura si Aleanca për Median Etike dhe një Kod Etik i përditësuar, në terren vihet re një hendek i theksuar mes standardeve të miratuara dhe praktikave të përditshme të gazetarisë lokale. Ky hendek, i cili në disa raste thellohet edhe nga ndërhyrjet politike, mungesa e resurseve apo kushtet e dobëta të punës, krijon një mjedis të brishtë ku dezinformimi, polarizimi dhe mungesa e përgjegjshmërisë profesionale mund të gjejnë terren të favorshëm për të lulëzuar.

Objektivi themelor i kësaj ndërhyrjeje, dhe si rrjedhim edhe i këtij raporti, është të kontribuojë në ndërtimin e një kulture të re profesionale ku vetërregullimi nuk perceptohet më si një luks i mediave të mëdha në Tiranë, por si një domosdoshmëri e përbashkët edhe për redaksitë më të vogla në qytetet e tjera të vendit. Fuqizimi i kësaj kulture përmes mjeteve të dialogut, reflektimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve, menaxherëve të mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, është një hap thelbësor drejt krijimit të një mjedisi informues më të përgjegjshëm, më etik dhe më të mbrojtur nga rreziqet e manipulimit dhe polarizimit shoqëror.

Ky raport, nuk ka vetëm funksion përshkrues, por synon të shërbejë si një udhërrëfyes i detajuar për mënyrën se si mund të strukturohet një ndërhyrje efektive për përforcimin e etikës mediatike në nivel lokal, duke u bazuar në realitetin konkret të Shkodrës dhe Vlorës dhe duke ofruar një model të ripërdorshëm edhe në qytete të tjera të vendit.

2. Justifikimi i ndërhyrjes

Përvoja e grumbulluar ndër vite nga organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet që monitorojnë zhvillimet në fushën e medias në Shqipëri dëshmon për një sfidë të thellë dhe të qëndrueshme që përfshin mediat lokale: mungesën e një sistemi të brendshëm etik të konsoliduar. Ndryshe nga mediat kombëtare të cilat, megjithë mangësitë e tyre, shpesh kanë në funksion struktura editoriale, kode të shkruara etike ose lidhje me mekanizmat e vetërregullimit kombëtar, mediat lokale shpesh operojnë në kushte shumë më të paqëndrueshme. Këto media karakterizohen nga burime të kufizuara njerëzore dhe financiare, nga cikle të shkurtra të jetës redaksionale dhe nga varësi të konsiderueshme ndaj reklamuesve lokalë, autoriteteve vendore apo interesave të tjera të ndërlidhura me pushtetin.

Pjesëmarrja e tyre në nisma kombëtare për vetërregullim, si Aleanca për Median Etike (AME), është minimale ose inekzistente. Në shumë raste, redaksitë lokale nuk janë të informuara mbi ekzistencën e këtyre mekanizmave, ose nuk i perceptojnë ato si të rëndësishme për praktikën e tyre të përditshme. Për më tepër, mungesa e një kulture profesionale që e shikon etikën si pjesë integrale të procesit të informimit dhe jo thjesht si një formalitet abstrakt, bën që gazetarët lokalë të mbeten të pambrojtur nga ndërhyrjet, presionet dhe nganjëherë edhe vetëcensura.

Në këtë vakum rregullator dhe profesional, përmbajtja mediatike që prodhohet shpesh karakterizohet nga mungesa e verifikimit të informacionit, njëanshmëri në pasqyrimin e zhvillimeve dhe tendenca për të reflektuar më shumë interesat e ngushta të aktorëve lokalë se sa interesin publik. Kjo krijon një kontekst ku dezinformimi mund të përhapet me lehtësi dhe ku polarizimi shoqëror, i ndikuar nga dasitë politike, ekonomike apo kulturore, jo vetëm që nuk sfidohet nga media, por përkundrazi, ndonjëherë nxitet në mënyrë të pandërgjegjshme prej saj.

Në këtë sfond, ndërhyrja e propozuar synon të vendosë themele për një qasje të re, të strukturuar dhe të përshtatur me realitetin lokal, që ka për qëllim të:

- Risë ndërgjegjësimin e aktorëve mediatikë për rëndësinë thelbësore që ka vetërregullimi në ndërtimin e besueshmërisë dhe legjitimitetit të medias;
- Zbulojë dhe analizojë pengesat konkrete që i ndalojnë këto media të ndërmarrin hapa drejt përfshirjes në rrjete vetërregulluese apo drejt ndërtimit të mekanizmave të brendshëm të etikës;
- Zhvillojë rekomandime praktike dhe të zbatueshme, që i përgjigjen specifikisht realitetit të Shkodrës dhe Vlorës, por që mund të shërbejnë edhe si modele për qytete të tjera me karakteristika të ngjashme.

Qasja e ndjekur nuk është normuese nga lart-poshtë, por synon të nxisë reflektim të brendshëm, dialog profesional dhe mbështetje ndërvepruese për ndërtimin gradual të vetërregullimit si një proces i nxitur nga vetë komuniteti mediatik lokal.

3. Qasja metodologjike

Për të qenë në përputhje me qëllimet e projektit dhe për të garantuar një qasje reale dhe të ndjeshme ndaj kushteve të mediave lokale në Shqipëri, metodologjia e zhvilluar është ndërtuar mbi parimin e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të aktorëve të fushës. Ajo

bazohet në një *qasje partnere dhe konsultative*, që e sheh median lokale jo si objekt vëzhgimi, por si palë aktive në identifikimin e problemeve dhe formulimin e zgjidhjeve.

Ky model kërkimor dhe ndërhyrës nuk imponon modele të gatshme vetërregullimi, por përpiqet të përthithë përvojat, shqetësimet dhe vizionin e vetë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë relevantë. Në thelb, kjo metodologji synon të gjenerojë dije praktike dhe të përdorshme, që është në të njëjtën kohë empirike, analitike dhe e zbatueshme në një kontekst të kufizuar nga burimet dhe kapacitetet.

Për këtë qëllim, metodologjia ndërthur tre shtylla kryesore:

1. Metoda të hulumtimit cilësor. Kjo përfshin përdorimin e fokus grupeve dhe tryezave të rrumbullakëta si mjete për të mbledhur të dhëna të thelluara dhe të pasura përmes diskutimeve të strukturuar ndërmjet gazetarëve, menaxherëve të mediave dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Këto forma mundësojnë nxjerrjen në pah të perceptimeve të brendshme, përvojave praktike, vështirësive të përditshme dhe nivelit të gatishmërisë për të ndërmarrë nisma vetërregulluese.
2. Instrumente të strukturuar vlerësimi. Përveç metodave narrative, nëse rasti mundëson, të përdoren pyetësorë të dizajnuar për të mbledhur të dhëna krahasimore dhe për të matur perceptime, praktika dhe vështirësi në mënyrë më sistematike. Po ashtu, ekspertët do të hartojnë skenarë që do të përdoren gjatë tryezave për të stimuluar debat mbi situata konkrete etike, duke nxitur reflektim të drejtpërdrejtë mbi reagimet dhe vendimmarrjet profesionale.
3. Rishikim dhe analizë e kontekstit lokal. Gjithçka do të mbështetet mbi një analizë të mëparshme të terrenit në Shkodër dhe Vlorë, ku do të identifikohen veçoritë socio-politike dhe ekonomike të mjedisit ku operojnë mediat. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimit të autoriteteve vendore, pranisë së rrjeteve informale të ndikimit dhe nivelit të përgjithshëm të lirisë së medias dhe transparencës në secilin qytet.

Bazuar në qasjen e mësipërme, metodologjia synon të realizojë katër objektiva të ndërthurur dhe të matshëm:

1. Të identifikojë perceptimet dhe kuptimin e etikës dhe vetërregullimit nga gazetarët lokalë. Kjo është një pikënisje thelbësore, sepse vetë përkufizimi që u jepet termave si "etikë", "pavarësi", apo "vetërregullim" nga komuniteti lokal gazetaresk, ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e çdo ndërhyrjeje. Nëse këto nocione perceptohen si të huaja, teorike apo të pamundura për t'u zbatuar, atëherë çdo përpjekje për institucionalizim etik do të përballet me rezistencë të heshtur ose të hapur.
2. Të analizojë pengesat institucionale dhe kulturore për zbatimin e vetërregullimit. Përmes diskutimeve dhe mundësisht pyetësorëve, ekspertët do të synojnë të shpalosin faktorët që pengojnë ose frenojnë ndërtimin e strukturave të vetërregullimit, qoftë ato të brendshme në media të veçanta, qoftë në nivel më të gjerë komunitar. Kjo analizë do të përfshijë aspekte si mungesa e resurseve, ndërhyrjet politike, presionet ekonomike, mungesa e kulturës së debatit profesional dhe vështirësitë e bashkëpunimit mes mediave rivale.
3. Të mundësojë shkëmbimin e praktikave pozitive dhe rekomandimeve midis aktorëve të ndryshëm. Qëllimi nuk është vetëm të identifikohen problemet, por të aktivizohet një platformë debati profesional ku aktorët lokalë të kenë mundësi të ndajnë përvoja të suksesshme, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të ndërtojnë një ndjenjë bashkësie rreth praktikave të mira. Kjo është një formë "ndërgjegjësimi i përbashkët", që është më e qëndrueshme sesa ndërgjegjësimi individual përmes trajnimeve të zakonshme.

4. Të përgatisë terrenin për angazhimin e mëvonshëm në rrjete si AME. Në fund të këtij procesi, synohet që pjesëmarrësit të mos shohin më vetërregullimin si një koncept abstrakt dhe të largët, por si një nevojë reale për funksionimin e tyre profesional. Ata do të ftohen të konsiderojnë mundësinë për t'u bërë pjesë e rrjeteve ekzistuese vetërregulluese, si Aleanca për Median Etike, ose të ndërmarrin hapa për të ndërtuar mekanizma të brendshëm të etikës në redaksitë e tyre.

4. Strukturimi i fokus grupeve dhe tryezave të rrumbullakëta

Qasja metodologjike e ndërhyrjes bazohet në krijimin e një hapësire të strukturuar dhe të sigurt për dialog ndërmjet aktorëve kryesorë të informacionit në nivel lokal. Kjo realizohet përmes zhvillimit të fokus grupeve dhe tryezave të rrumbullakëta, të cilat do të funksionojnë si një mekanizëm kërkimor dhe njëkohësisht si një formë ndërgjegjësimi dhe ndërtimi kapacitetesh. Qëllimi i këtyre ndërveprimeve nuk është vetëm mbledhja e të dhënave, por edhe aktivizimi i pjesëmarrësve për të reflektuar mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre profesionale në përmirësimin e mjedisit mediatik.

4.1. Përzgjedhja e pjesëmarrësve

Për çdo qytet pilot, Shkodër dhe Vlorë, do të organizohet një tryezë e rrumbullakët, dhe një mbledhje e strukturuar si fokus grup i zgjeruar. Përbërja e pjesëmarrësve është menduar të jetë e balancuar, e shumëllojshme dhe përfaqësuese e realitetit lokal, në mënyrë që diskutimi të jetë i pasur dhe me këndvështrime të ndryshme.

Kategoritë e pjesëmarrësve do të përfshijnë:

- 6 deri në 8 gazetarë aktivë të mediave lokale, të cilët do të përzgjidhen në mënyrë që të përfaqësojnë më shumë se një institucion mediatik (televizione lokale, portale online, radio, gazeta të shtypura). Përzgjedhja do të ketë parasysh diversitetin gjinor, përvojën profesionale, por edhe gatishmërinë për të kontribuar në diskutim.
- 2 deri në 3 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile lokale, që veprojnë në fushat e medias, transparencës, të drejtës për informim, pjesëmarrjes qytetare apo të drejtave të njeriut. Këto organizata, ndonëse nuk janë media në kuptimin klasik, shpesh kanë rol të rëndësishëm në nxitjen e etikës, përgjegjshmërisë dhe monitorimit të mediave në komunitet.
- 1 deri në 2 ekspertë të ftuar, me përvojë profesionale në fushën e etikës së medias, vetërregullimit ose të drejtës mediatike, të cilët do të kontribuojnë me perspektiva krahasuese, përvojë kombëtare dhe analiza kritike të rasteve.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis Këshillit Shqiptar të Medias dhe Res Publica, duke u bazuar si në rrjetet ekzistuese të kontakteve, ashtu edhe në ftesa publike të targetuara përmes kanaleve zyrtare dhe mediave lokale. Pjesëmarrja do të jetë me ftesë të personalizuar, duke siguruar një përzgjedhje cilësore dhe një përfaqësim të balancuar midis gjinive, përvojave profesionale dhe orientimeve editoriale.

4.2. Strukturimi i seancave

Çdo tryezë do të zgjasë rreth 2.5 deri në 3 orë dhe do të ndahet në tre sesione të ndërthurura logjike, të cilat do të drejtohen nga një moderator ekspert dhe do të ndihmohen nga një bashkë-moderator ose facilituese logjistike.

Sesioni 1: Perceptimi mbi etikën dhe vetërregullimin

Ky sesion ka për qëllim të eksplorojë se si gazetarët dhe aktorët e tjerë lokalë e konceptojnë dhe e përjetojnë etikën profesionale dhe vetërregullimin në praktikën e tyre të përditshme. Ky sesion do të shërbejë si një pasqyrë fillestare për të kuptuar thellësinë e sfidës dhe për të ndërtuar një gjuhë të përbashkët mes pjesëmarrësve. Diskutimi do të fokusohet në pyetje si:

- Çfarë nënkuptojmë me "etikë" në median lokale?
- Si përkufizohet vetërregullimi dhe a është i pranueshëm si koncept në këtë kontekst?
- A ekzistojnë forma të brendshme vetërregullimi në redaksitë lokale, si kode etike të shkruara, rregulla editoriale, ose komitete redaksionale që trajtojnë konfliktet?
- Çfarë përvojash konkrete kanë gazetarët me presionet politike dhe ekonomike dhe si i kanë përballuar ato?

Sesioni 2: Pengesat dhe mundësitë

Në këtë pjesë, diskutimi kalon nga niveli i përshkrimit në atë analitik. Ky sesion synon të dalë nga diskutimi reflektiv me një hartë të qartë të sfidave, por edhe të dritareve të mundshme për ndërhyrje dhe mbështetje. Pjesëmarrësit do të ftohen të analizojnë:

- Cilat janë pengesat konkrete që i ndalojnë mediat lokale të aplikojnë parimet e vetërregullimit?
- A janë këto pengesa të natyrës financiare, strukturore, kulturore apo të lidhura me mungesën e njohurive dhe trajnimeve?
- A ekziston vullneti i brendshëm për të ndërtuar një sistem të thjeshtë vetërregullimi?
- A ka interes për t'u bërë pjesë e mekanizmave kombëtarë si Aleanca për Median Etike (AME), dhe cilat janë hezitimet në këtë drejtim?

Sesioni 3: Rekomandime dhe mekanizma praktikë

Në pjesën përfundimtare, pjesëmarrësit do të inkurajohen të propozojnë zgjidhje të mundshme dhe hapa konkretë për përmirësimin e etikës në nivel lokal. Pyetjet orientuese do të përfshijnë:

- Si mund të ndërtohet një model i thjeshtë vetërregullimi në një redaksi të vogël?
- A mund të krijohen kode të brendshme etike edhe në media me staf minimal?
- A mund të krijohen struktura informale, si takime të rregullta midis mediave lokale për shkëmbim praktike që shërbejnë si një pararendës i institucionalizimit etik?
- Çfarë mbështetjeje presin nga rrjetet ekzistuese kombëtare apo organizatat e shoqërisë civile?

Për të ndihmuar në konkretizimin e këtyre ideve, ekspertët do të ofrojnë modele nga përvoja ndërkombëtare dhe instrumente të thjeshta që mund të përshtaten në kontekstin lokal.

5. Ndërthurja me çështje ndërsektoriale

Një komponent kyç i metodologjisë së propozuar është integrimi i çështjeve ndërsektoriale në të gjitha fazat e projektit, si në përzgjedhjen e pjesëmarrësve, ashtu edhe në hartimin e instrumenteve dhe analizën e të dhënave. Kjo qasje është thelbësore jo vetëm për të respektuar standardet e përfshirjes dhe barazisë, por edhe për të garantuar që produktet e ndërhyrjes të reflektojnë realisht kompleksitetin e mjedisit mediatik lokal dhe sfidat me të cilat përballen aktorët më të pambrojtur në të.

Përfaqësim gjinor i balancuar

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve për tryezat e rrumbullakëta dhe fokus grupet, metodologjia parashikon që të paktën 40% e tyre të jenë gra, me synimin për të arritur barazi të plotë nëse kushtet e terrenit e lejojnë. Ky parashikim nuk është thjesht formal, por mbështetet në njohjen e fakteve empirike që tregojnë se gratë gazetare, sidomos në mediat lokale, përballen shpesh me sfida të shumfishta: nga seksizmi në vendin e punës dhe mungesa e përfaqësimit në pozita drejtuese, deri te ekspozimi i shtuar ndaj gjuhës së urrejtjes dhe formave të tjera të dhunës dixhitale. Përfshirja e tyre në mënyrë të qëllimshme do të mundësojë evidentimin e këtyre përvojave dhe ndërtimin e një kuadri rekomandimesh që i adreson në mënyrë specifike.

Përfshirja e gazetarëve nga grupe të nënpërfaqësuar

Metodologjia gjithashtu vendos fokus të veçantë në përfshirjen e gazetarëve që përfaqësojnë komunitete të marginalizuara ose që operojnë jashtë strukturave tradicionale të medias. Kjo përfshin, ndër të tjera:

- Gazetarët e rinj, të cilët shpesh janë të angazhuar në mënyrë freelance ose në portale të reja me natyrë eksperimentale;
- Përfaqësues të mediave komunitare apo alternative, të cilat nuk kanë infrastrukturën e mediave klasike, por luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e çështjeve lokale;
- Anëtarë të pakicave etnike dhe gjuhësore, të cilët mund të mos kenë akses të barabartë në hapësirat kryesore të informimit, por që shpesh zhvillojnë nisma të vetë-organizuara për të artikulluar interesat e komunitetit të tyre.

Përfshirja e këtyre zërave do të ndihmojë në krijimin e një kuadri vetërregullimi që është gjithëpërfshirës dhe që nuk reflekton vetëm nevojat e mediave të konsoliduara, por edhe të aktorëve më të rinj dhe të pambështetur institucionalisht.

Ndjeshmëria për qasjet e reja të komunikimit, përfshirë mediat sociale

Një aspekt i rëndësishëm i kontekstit bashkëkohor mediatik është zhvendosja gjithnjë e më e madhe e prodhimit dhe konsumit të informacionit drejt platformave online dhe mediave sociale. Në veçanti në mjediset lokale, shumë prej përmbajtjeve që qarkullojnë me ndikim të lartë nuk kalojnë përmes kanaleve tradicionale të kontrollit editorial, por shpërndahen përmes Facebook ose Instagram, shpesh nga faqe pa autorësi të qartë apo standarde etike.

Metodologjia e ndërhyrjes reflekton mbi këtë realitet duke përfshirë në diskutim edhe aktorë të mediave sociale, administratorë faqesh lokale, dhe duke analizuar se si mund të shtrihet vetërregullimi edhe në këtë sferë. Po ashtu, skenarët dhe pyetjet e tryezave do të adresojnë problematika të lidhura me etikën në komunikimin online, si përhapja e lajmeve të rreme, përdorimi i clickbait-it, mungesa e burimeve, etj.

Në këtë mënyrë, ndërhyrja jo vetëm që synon të ndërtojë mekanizma të etikës për media të strukturuar, por edhe të hapë diskutimin për *kufijtë e rinj të vetërregullimit* në epokën e mediave sociale dhe gazetarisë së shpërndarë.

Në tërësi, kjo ndërlidhje me çështjet ndërsektoriale garanton që ndërhyrja të jetë jo vetëm teknikisht e justifikuar, por edhe etikisht legjitime, socialisht përfshirëse dhe e ndjeshme ndaj kompleksitetit të fushës. Ajo përmbush kështu jo vetëm qëllime operacionale, por edhe parime të barazisë dhe drejtësisë sociale, të domosdoshme për një mjedis mediatik të shëndetshëm dhe demokratik.

6. Roli i ekspertëve në këtë metodologji

Roli i dy ekspertëve të angazhuar në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e kësaj metodologjie është thelbësor për garantimin e cilësisë, koherencës dhe efektivitetit të ndërhyrjes. Këta ekspertë nuk funksionojnë thjesht si hartues teknikë të instrumenteve të kërkimit, por si projektues të gjithë qasjes konceptuale dhe njëkohësisht si facilitues të përfshirjes së aktorëve lokalë. Ndërveprimi i tyre me pjesëmarrësit, me partnerët e projektit dhe me bashkëpunëtorët e tjerë siguron që ndërhyrja të jetë reale, e arsyetuar dhe e pranueshme për mjedisin ku aplikohet.

Më konkretisht, ekspertët do të ushtrojnë funksione të shumëfishta që ndjekin një logjikë të integruar të ndërhyrjes, si më poshtë:

a. Hartimi i dokumentit metodologjik për orientimin e fokus grupeve dhe tryezave

Ekspertët do të zhvillojnë dokumentin e posaçëm metodologjik që shërben si udhërrëfyes praktik për organizimin dhe zbatimin e fokus grupeve dhe tryezave të rumbullakëta, i cili përfshin:

- Qëllimet dhe rezultatet e pritshme të procesit ndërveprues;
- Strukturën logjike të seancave dhe kohëzgjatjen e tyre;
- Skemat e pyetjeve të diskutimit dhe skenarët e ndërtuar mbi situata reale etike;
- Udhëzime për përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe ruajtjen e balancës gjinore, profesionale dhe tematike;

Ky dokument do të jetë baza e çdo veprimtarie kërkimore dhe reflektuese që zhvillohet në terren dhe do të sigurojë koherencën ndërmjet qyteteve të përzgjedhura dhe ndërmjet aktiviteteve të ndryshme.

b. Bashkëpunimi me studiuesin për ndërtimin e boshtit teorik dhe konceptual të ndërhyrjes

Ekspertët do të bashkëpunojnë ngushtë me studiuesin e angazhuar në projekt (pozicioni 3.2.1), për të ndërtuar një kuadër të qartë konceptual mbi të cilin do të mbështetet ndërhyrja. Ky bosht teorik përfshin:

- Përkufizimin e vetërregullimit dhe etikës në kontekstin shqiptar lokal;
- Ndërlidhjen ndërmjet standardeve ndërkombëtare dhe praktikave kombëtare në gazetari;
- Identifikimin e faktorëve socialë, institucionalë dhe kulturorë që ndikojnë në zbatueshmërinë e mekanizmave të vetërregullimit;

- Ndërtimin e një rrëfimi argumentues që shpjegon nevojën për veprim në këtë fushë dhe vendos ndërhyrjen në një kontekst më të gjerë demokratik dhe zhvillimor.

Ky bashkëpunim është jetik për të garantuar që puna në terren nuk është thjesht operative, por është e rrënjësuar në analiza kritike dhe në teori që i japin kuptim dhe legjitimitet ndërhyrjes.

c. Mbikëqyrja e zbatimit pilot të tryezave dhe fokus grupeve

Ekspertët do të jenë të pranishëm fizikisht në të gjitha tryezat dhe fokus grupet që do të zhvillohen në Shkodër dhe Vlorë, me funksionin e mbikëqyrjes cilësore dhe mbështetjes për facilituese lokale apo partnerët implementues. Ata do të:

- Monitorojnë mënyrën e zbatimit të skemës metodologjike;
- Sigurojnë që diskutimi të mos devijojë nga objektivat e vendosura;
- Ndërhyjnë në rast se hasen pengesa ose tensione gjatë debatit;
- Vlerësojnë angazhimin e pjesëmarrësve, cilësinë e të dhënave të mbledhura dhe atmosferën e përgjithshme të bashkëpunimit.

Përveç rolit teknik, ekspertët do të shërbejnë edhe si observues të sjelljeve dhe reagimeve që nuk dalin drejtpërdrejt në diskutime, por që janë thelbësore për një analizë të thelluar kontekstuale.

d. Analiza përfundimtare e gjetjeve dhe kontributi në raportin vlerësues

Pas përfundimit të aktiviteteve në terren, ekspertët do të angazhohen në analizën përfundimtare të të dhënave të mbledhura, duke nxjerrë modele, tematika të përsëritura, tensione dhe rekomandime. Kjo analizë do të përdoret për:

- Hartimin e seksioneve përkatëse të raportit përfundimtar të projektit;
- Përcaktimin e hapave të rekomanduar për ndërtimin e mekanizmave të vetërregullimit në nivel lokal;
- Formulimin e një “pakete përgatitore” që mediat lokale mund të përdorin për të filluar procese të brendshme etike.

Ekspertët do të ofrojnë gjithashtu feedback teknik mbi raportin përfundimtar, duke rishikuar përmbajtjen për koherencë, saktësi dhe cilësi profesionale. Ata do të bëjnë korrektive gjuhësore dhe përmbajtësore, si dhe do të sugjerojnë përmirësime për përfundimin e argumentit dhe prezantimit të rezultateve.

Në tërësi, roli i ekspertëve është qendror për të garantuar që kjo ndërhyrje të mos mbetet thjesht një projekt i kufizuar në kohë, por të shërbejë si pikënisje për një transformim të qëndrueshëm në mënyrën se si mediat lokale e perceptojnë dhe praktikojnë etikën dhe vetërregullimin. Ata janë urë lidhëse midis teorisë dhe praktikës, ndërmjet ideve dhe zbatimit, ndërmjet standardit dhe realitetit.

7. Rezultatet e pritshme nga kjo metodologji

Zbatimi i kësaj metodologjie nuk ka për qëllim vetëm realizimin e një aktiviteti të izoluar në kuadër të projektit, por ndërtimin e një baze të qëndrueshme për reflektim profesional, përpunim konceptual dhe veprim praktik në fushën e vetërregullimit mediatik në nivel lokal. Për këtë arsye, rezultatet e saj janë projektuar të jenë konkrete, të shumëfunksionale dhe të ripërdorshme, si

brenda këtij projekti, ashtu edhe në nisma të tjera të ngjashme në të ardhmen. Më konkretisht, metodologjia pritet të prodhojë këto tre rezultate kryesore:

a. Një raport i brendshëm metodologjik për përdorim të brendshëm dhe trajnues

Ky dokument do të përmbajë të gjitha komponentët themelorë të qasjes së zhvilluar nga ekspertët, duke përfshirë:

- Strukturën konceptuale të metodologjisë;
- Parimet mbi të cilat mbështetet ndërhyrja;
- Instrumentet e përdorura (pyetësorë, skenarë, modele për tryezat, etj.);
- Udhëzime praktike për zbatimin në kontekste të tjera.

Raporti metodologjik do të përdoret si material orientues për partnerët, për aktorët e përfshirë në projekt, si dhe për çdo organizatë që dëshiron të ndërmarrë ndërhyrje të ngjashme në mjedise të tjera mediatike. Ai do të shërbejë gjithashtu si bazë për zhvillimin e moduleve të trajnimit, që mund të përdoren në kontekste formale dhe joformale për të rritur kapacitetet e gazetarëve lokalë.

b. Një strukturë e standardizuar e tryezave dhe fokus grupeve që mund të ripërdoret në zona të tjera

Një nga aspektet më të rëndësishme të kësaj metodologjie është që ajo nuk është e ndërtuar vetëm për rastin e Shkodrës dhe Vlorës, por është projektuar në mënyrë që të jetë e transferueshme dhe e përshtatshme për kontekste të tjera lokale. Kjo strukturë standarde do të përfshijë:

- Një model fiks të sesioneve të tryezave, të ndarë sipas tematikave dhe pyetjeve orientuese;
- Format të pjesëmarrjes dhe udhëzime për përzgjedhjen e aktorëve lokalë;
- Mekanizma për dokumentimin e gjetjeve dhe përpunimin e tyre në mënyrë të dobishme.

Kjo strukturë do të shërbejë si template për organizimin e dialogut profesional lokal në rrethe të tjera të vendit dhe do të mundësojë krahasueshmërinë ndërmjet zonave për të identifikuar tendenca kombëtare dhe veçori rajonale.

c. Një përmbledhje e rekomandimeve specifike për mediat lokale, që mund të integrohen në raportin përfundimtar të projektit

Pasi të jetë përfunduar procesi i fokus grupeve dhe tryezave, ekspertët do të marrin në konsideratë një përmbledhje të rekomandimeve të dala nga vetë pjesëmarrësit, të pasuruara dhe sistemuara përmes analizës teknike. Këto rekomandime do të fokusohen në:

- Veprime të mundshme që mund të ndërmerren nga redaksitë lokale për të ngritur mekanizma të brendshëm vetërregullimi;
- Formulime të thjeshtuara të kodeve të etikës të përshtatura për mediat me staf minimal;
- Rrugë të mundshme për afrimin me mekanizmat kombëtarë si AME;
- Nevoja për mbështetje të jashtme (trajnime, materiale ndihmëse, akses në rrjete).

Ky grup rekomandimesh do të përbëjë bazën e komponentit analitik të raportit përfundimtar të projektit, duke i dhënë atij peshë praktike dhe dimension përdorueshmërie konkrete.

8. Përfundime

Metodologjia e ndërtuar në kuadër të këtij projekti nuk është konceptuar si një mjet klasik i grumbullimit të të dhënave, i kufizuar në dimensionin e vet teknik apo raportues. Ajo është menduar dhe ndërtuar si një proces gjithëpërfshirës dhe transformues, që synon të angazhojë mediat lokale jo vetëm si burim informacioni, por si aktorë të ndërgjegjshëm dhe bashkëformues të zgjidhjes për një nga sfidat më të rëndësishme që përballon gazetaria sot: mungesa e vetërregullimit dhe pasojat që kjo sjell në cilësinë e informacionit publik, në besueshmërinë e medias dhe në shëndetin e demokracisë në nivel lokal.

Kjo metodologji synon të krijojë një hapësirë reflektimi kolektiv, ku gazetarët, redaktorët, aktivistët e shoqërisë civile dhe ekspertët e fushës të mund të ndajnë përvoja, të ndërtojnë gjuhë të përbashkët dhe të shpalosin gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë hapa të qëndrueshëm në drejtim të etikës profesionale. Ky reflektim nuk është i orientuar nga jashtë, por buron nga vetë përvoja e përditshme dhe sfidat konkrete me të cilat përballen profesionistët e informacionit në një kontekst lokal shpeshherë të ndërlikuar, me presione të shumta ekonomike, politike dhe sociale.

Për më tepër, ndërhyrja nuk ka për synim që të prodhojë një rekomandim të vetmuar që arkivohet në fund të projektit, por të ngrejë një model që mund të ripërdoret, të zgjerohet dhe të përshtatet në zona të tjera të vendit. Kjo i jep metodologjisë një karakter të zgjerueshëm në nivel kombëtar, duke e bërë atë një instrument të vlefshëm jo vetëm për qytetet e përzgjedhura në këtë fazë, por edhe për të gjithë spektrin e mediave lokale në Shqipëri, të cilat ndajnë problematika të ngjashme strukturore dhe profesionale.

Në fund, ajo që synon kjo metodologji është të krijojë një kulturë të re profesionale në mjediset lokale të informimit, një kulturë që nuk pret që zgjidhjet të vijnë nga jashtë, por që beson në kapacitetin e vetë mediave për të rishikuar veten, për të vënë në diskutim praktikatat e tyre dhe për të ndërtuar gradualisht standarde që burojnë nga brenda komunitetit mediatic vetë. Vetëm në këtë mënyrë, vetërregullimi mund të jetë real, i qëndrueshëm dhe me ndikim afatgjatë. Vetëm në këtë mënyrë, mediat lokale mund të kthehen në një faktor të besueshëm dhe të përgjegjshëm në shoqërinë demokratike shqiptare.